



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 687/9 Prot.

Tiranë, më 12.9.2018

V E N D I M

Nr. 126, Datë 12.9.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË HAS ME OBJEKT “AUDITIM RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”, PËR PERIU DHËN 01.01.2016 – 31.12.2017

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Has, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (por jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Fusha kryesore ku janë evidentuar mangësitë në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në zbatimin e procedurave të prokurimit të fondeve me vlera të mëdha dhe të vogla, në zbatimin e kontratave të punëve publike, në menaxhimin e pronës (aseteve) të kësaj bashkie dhe në fushën e menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të rregullshmërisë financiare të ushtruar në Bashkinë Has, sipas programit nr. 687/1 prot, datë 12.06.2018 për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A-MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me degën e thesarit për vitin 2016, shpenzimet buxhetore në Bashkinë Has janë planifikuar në vlerën 663,797,613 lekë dhe realizuar në vlerën 556,889,992 lekë, me diferencë më pak vlera prej 96,907,665 lekë ose në masën 83%. Për vitin 2017 shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 657,565,948 lekë dhe realizuar në vlerën 591,396,850 lekë me diferencë më pak vlera prej 66,169,098 lekë ose në masën 90%. Për vitin 2017 janë planifikuar 42 investime në vlerën 246,116,317 lekë dhe realizuar 28 investime në vlerën 200,236,962 lekë me 12 investime të palikuiduar në vlerën 45,880,355 lekë ose në masën 81,35%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë shpenzuese në drejtim të këtyre shërbimeve. Këshilli Bashkisë Has nuk ka dokumentuar veprimtarinë e komisionit të financave i cili vepron gjatë gjithë periudhës së mandatit, ky komision ka si funksion të kontrollojë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga këshilli, në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” (*Trajtuar hollësisht në pikën III/3.a dhe faqen 41-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca ndërmjet parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Has të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga Këshilli i Bashkisë Has të dokumentohet veprimtaria e komisionit të financave në mënyrë periodike, gjatë gjithë periudhës së mandatit, duke kontrolluar të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga këshilli bashkiak dhe me analiza të punës për realizimin e buxheteve paraardhës të bëhen, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve të viteve.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has ka një numër të konsiderueshëm fatura të pa likuiduara në vlerën **48,635,002 lekë**, për shërbime dhe mallra të prokuruar, një pjesë e të cilave janë të trashëguara para dhe pas reformës territoriale në vlerën prej 2,615,751 lekë nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Sipas të dhënave të Sektorit të Financës deri me datë 31.08.2018 është likuiduar vlera 46,524,480 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 2,110,522 lekë (*Trajtuar hollësisht në pikën III/3.c dhe faqen 55-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Financës Bashkia Has, të marrë masa për parashikimin e shpenzimeve në nivele të realizueshme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **2,110,522 lekë**, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, dhe të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite shoqëruar me grafikun për shlyerjen e detyrimeve.

Brenda datës 31.10.2018

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën raportuese objekt auditimi 2016-2017 në strukturën organizative të Bashkisë Has nuk është ngritur dhe funksionuar Njësia e Auditit të Brendshëm, veprim në mospërputhje me detyrimin ligjor i përcaktuar nga neni 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e “Manuali Auditimit të Brendshëm”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2 dhe faqen 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen në strukturën organizative dhe funksionimi Njësinë e Auditit të Brendshëm me specialist të fushës.

Në rast mungese të specialistëve të shikohet mundësia e lidhjes së aktmarrëveshjes me Njësia e Auditit të Brendshëm të një njësie tjetër publike, marrëveshje e cila duhet paraprakisht të miratohet nga Ministri i Financave, në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave. Ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të përshkruara në rregulloren e brendshme, monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative. Nuk është aplikuar metoda e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. *(Trajtuar hollësisht në pikën III/2 dhe faqen 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari Bashkisë Has në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a-Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë për identifikimin e dobësive dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë, duke marrë në konsideratë prioritetet e Bashkisë.

b-Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale, si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

c- Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut, të ndërtojë një plan pune me detyra të mirëpërcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës.

Të dokumentojë regjistrin qendror të riskut si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në njësinë shpenzuese Bashkia Has (*Bordi Kullimit, periudha raportuese 2016 për objekte të transferuara*), është kryer inventarizimi fizik i aktiveve (aseteve) të institucionit në objektet; “*Rezervuari Vranisht dhe rezervuari Diga*” të kontabilizuar në llogaria nr. 213 me vlerë 59,664,092 lekë. Në përfundim të inventarizimit ndërmjet gjendjes kontabël (në pasqyrën financiare) dhe gjendjes fizike rezultoi diferencë, me specifikimin e komisionit të inventarizimit “*Nuk ekziston*”, si rezultat i mos administrimit dhe rakordimit të këtyre objekteve, ashtu si është pasqyruar në shkresën e dërguar nga Bordi Rajonal i Kullimit Lezhë.

Me inventarizimin fizik në periudhën raportuese 2017, kjo gjendje është sistemuar vetëm për objektin “*Rezervuari Diga Has*” me vlerë 4,023,489 lekë, pasi në fletë inventarizimin e aseteve objekti “*Rezervuari Vranisht*” me vlerë 55,640,243 lekë është evidentuar përsëri me gjendje fizike 0 (zero).

Për pasojë mos sistemimi dhe mos rakordimi i aktivitetit brenda periudhës së ndërtimit të pasqyrave financiare, nuk mund të quhet se ato pasqyrojnë realitetin e gjendjes së pasurisë dhe aseteve të institucionit *(Trajtuar hollësisht në pikën III/3.c dhe faqen 55-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori i Financës në bashkëpunim me Bordin Rajonal të Kullimit Lezhë, të marrin masat të plota për të sistemuar e rakorduar gjendjen fizike me atë kontabël të aktivitetit të pasurisë objekti “Rezervuari Vranisht” me vlerë 55,640,243 lekë me qëllim saktësimin e gjendjes fizike e kontabël, nëpërmjet ballafaqimit edhe një herë me Bordin Rajonal të Kullimit Lezhë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare më 31.12.2018

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë realizuar në vlerën 16,706 mijë lekë ose 165 %, ndërsa për vitin 2017 janë realizuar në vlerën 17,773 mijë lekë ose 115%. Realizimi i treguesve të planit nuk tregon se puna në këtë njësi është e mirorganizuar, pasi planifikimi i të ardhurave nuk është bërë sipas nevojave dhe mundësive që ka kjo njësi, duke mos planifikuar saktë detyrimet për disa lloj taksash, konkretisht: *Në vitin 2016*, nga taksa e regjistrimit të mjeteve ka mos planifikim në vlerën 1,639 mijë lekë, për taksën e pastrimit kemi mos planifikim në vlerën 1,671 mijë lekë, mos planifikim i tatimit thjeshtuar mbi fitimin (nga DPT Kukës) në vlerën 642 mijë lekë dhe mos planifikim debitorësh në vlerën 1,716 mijë lekë. *Ndërsa në vitin 2017*, nuk janë planifikuar taksa ndikim në infrastrukturë nga ALUIZNI në vlerën 951 mijë lekë, qira kullote në vlerën 349 mijë lekë dhe detyrime të prapambetura në vlerën 2,021 mijë lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe agjentët tatimorë, të marrin masa për një planifikim sa më të drejtë të detyrimeve që rrjedhin nga taksat e tarifave vendore, duke i planifikuar ato sipas mundësive reale që ka Bashkia Has, kryesisht për taksën e infrastrukturës nga ndërtimet e reja, tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, taksa e regjistrimit të mjeteve, etj.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave për vjeljen e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore, konstatohet se deri më 31.12.2017 gjendja e detyrimeve për taksat e tarifave vendore paraqitet për **60** subjekte me vlerë **12,513,739 lekë**. Nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Has (zyra e taksave vendore), nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Has, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **12,513,739 lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, - Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Brenda datës 31.12.2018

8. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave Vendore, aplikon tarifa për familjarët vetëm për ato familje të cilët kërkojnë shërbim në Bashkinë Has, ndërsa për të tjerët nuk aplikojnë asnjë vlerë. Kështu referuar të dhënave të gjendjes civile për numrin e familjeve që duhet të paguajnë detyrimet është 6529 familje. Për periudhën objekt auditimi 2016 – 2017, kanë paguar detyrimet 2787 familje për vlerën 2,585,000 lekë, nga e cila për vitin 2016 në vlerën 1,511,000 lekë dhe në vitin 2017 në vlerën 1,074,000 lekë. Nuk është bërë i mundur planifikimi dhe arkëtimi i detyrimeve për 9800 familje në vlerën **9,800,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has *(Trajtuar më hollësisht në III/5 dhe faqen 132-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

8.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masat për arkëtimin e taksave të familjarëve, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare ose agjentëve të tjerë *(ndërmarrja e ujësjellësit)*, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara për vlerën **9,800,000 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimtarisë së IMTV Bashkia Has, konstatohet se nuk është bërë asnjë punë për evidentimin e objekteve të ndërtuar në territorin e Bashkisë Has. Kështu për periudhën objekt auditimi 2016 – 2017, është evidentuar vetëm për një objekt si ndërtim pa leje në pronësi të J. I. C, por që nuk është marrë asnjë masë ligjore. Me urdhër nr. 414, datë 05.07.2018 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur një grup pune për verifikimin në terren të ndërtimeve pa leje, kjo në zbatim të kërkesës së grupit të auditimit datë 05.07.2018, ku sipas informacionit të ardhur është konstatuar se në këtë territor janë 6 ndërtime pa leje të ngritura *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1 dhe faqen 141-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

9.1. Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Has, të marrë masat për evidentimin e të gjitha objekteve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Has dhe në rast të evidentimit të objekteve pa leje të ndërmerren hapat ligjorë.

Për 7 rastet e konstatuara me ndërtim pa leje, IMTV të vazhdojë procedurat për aplikimin e gjobës për vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, në zbatim të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 52, *Kundërvajtjet administrative*, shkronja (e).

Për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv dhe të përllogariten kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, konkretisht për personat: H. L, A. M, N. N, B. D, H. K, H. H dhe J. I. C.

Brenda datës 30.11.2018

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has, puna për regjistrimin e pronave në pronësi nuk është në nivelin e kërkuar, pasi nga moria e pronave që ka bashkia janë dërguar në ZVRPP vetëm 52 prona, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar *(Trajtuar hollësisht në pikën III/7 dhe faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

10.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e të gjitha pronave dhe krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Has, në

zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të rekomandimeve, paraqitur me shkresën nr. 241/9, datë 21.07.2016 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1113/136, datë 31.01.2017, konstatohet se pavarësisht nga puna e bërë, Bashkia Has është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktar nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkitimit të dëmit, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46, të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), sipas vendimit administrativ të dënimit me gjobë.

Situata e realizimit të rekomandimeve, paraqitet si vijon:

-Nga 22 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 10 masa, janë në proces 7 masa dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative;

-Nga 23 masa shpërblim dëmi me vlerë 34,009,461 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, është zbatuar një masë në vlerën 440,000 lekë, në proces zbatimi 11 masa me vlerë 23,870,974 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 9,849,678 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 14,021,296 lekë, nuk janë zbatuar 11 masa në vlerën 9,698,487 lekë.

-Në lidhje me masat disiplinore nga 10 masa janë zbatuar plotësisht 10 masa;

-Nga 14 masa administrative, janë në proces 10 masa nga APP dhe nuk janë zbatuar 4 masa nga IMTK. (Trajtuar hollësisht në pikën III/1 faqe 11-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH dërguar me shkresën nr. 241/9, datë 21.07.2016 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1113/136, datë 31.01.2017, duke u përqendruar në:

a-Për masa organizative në pikat: 8; 11; 19; 20; 21 dhe 22;

b-Për të gjitha pikat e masës shpërblim dëmi në vlerën **21,152,280 lekë**, duke përjashtuar pikën 4;

c-Për masa administrative sipas vendimit të APP nr. 73, datë 15.09.2016 për arkëtimin e penalieteve të vendosura në vlerën **2,230,000 lekë** dhe mos dërgim shkresë në adresë të IMTK për penalizmin e mbikëqyrësve.

Brenda datës 30.11.2018

12. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit analizojë ankesën e paraqitur nga qytetari A. Q, me shkresën (prot KLSH nr. 811, datë 05.07.208), në lidhje me gjobën që i është bërë nga ana e Auditit të Prefekturës Kukës në masën 150,000 lekë për mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurave të prokurimit në kohën kur A. Q. ka qenë Kryetar i KVO në ish- komunën Fajzë.

Sipas ankuesit A. Q, në kontrollin e kryer nga grupi i auditimit të Prefekturës Kukës, nuk jam vënë në dijeni të faktit që ish- komuna Fajzë po auditohet periudha ime, informacion të cilin e mora pasi fillova punë në NJA Fajzë në datë 15.03.2017, kur nga Sektori i Financës jam njoftuar për kryerjen e ndalesave për gjobën e aplikuar nga Auditit i Prefekturës Kukës, si rezultat i shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit në vlerën 50,000 lekë sipas Raport Auditimit të kryer për periudhën nga 01.07.2004 deri me 30.06.2005 dhe në vlerën 100,000 lekë sipas Raport Auditimit për periudhën 01.07.2005 deri me 31.12.2006.

Në lidhje me ankesën e paraqitur, sqarojmë se nga ana juaj duhej bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë, në përputhje me nenin 18-“Afati për ngritjen e padisë”, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe

grykimin e mos marrëveshjeve administrative” (Trajtuar hollësisht në pikën III/8 faqe 148-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Kryetarit të Bashkisë Has (nëpunësi urdhërues) dhe përgjegjësi i Zyrës së Financës (nëpunësi zbatues), që për të rikthyer në afat të drejtën e ankimunit A. Q, në zbatim të nenit 15, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit të Punës në R.SH dhe nenit 46, të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative”, të nxjerrë vendim administrativ për masat e gjobës së aplikuar nga Prefektura Qarkut Kukës në adresë të A. Q për shkeljet e evidentuara nga Auditimi i Prefekturës Qarku Kukës.

T’i kërkohet Prefekturës Kukës vendimin mbi penalizmin e A. Q në masën 100,000 lekë sipas Raportit Auditimit për periudhën 01.07.2005 deri me 31.12.2006, pasi nuk ndodhet në njësinë administrative Fajzë.

Menjëherë

13. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Has për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016 – 31.12.2017, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësi të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmisimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

B/I. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **16,717,188 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e shpenzimeve operative me destinacion “*Shpenzime për udhëtime brenda vendit*”, konstatohet se janë kryer në mospërputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 33,500 lekë** ndaj **4 punonjësve** (Trajtuar hollësisht në pikën III/3.c dhe faqen 55-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **33,500 lekë nga 4 punonjës**, respektivisht:

-vlera **11,000 lekë**, nga përfituesi D. K.

-vlera **11,000 lekë**, nga përfituesi D. G.

-vlera **5,500 lekë**, nga përfituesi P. C.

-vlera **6,000 lekë**, nga përfituesi S. L.

Brenda datës 30.11.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2016 me objekt: “Blerje Çakëlli dhe shpërndarje me makineri, dhe riparime tjera te rrugëve rurale Bashkia Has” me fond limit 8,333,000 lekë, me fitues OE “S.....K” me ofertë 5,750,100 lekë, konstatohet se afati për përfundimin e punimeve është 10 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës. Kontrata nr. 1694, datë 22.08.2016, afati për përfundimin e punimeve është me datë 02.09.2016. Punimet kanë përfunduar me datë 19.09.2016, sipas faturës nr. 59, datë 19.09.2016 që shoqëron sitacionin në vlerën 4,794,840 lekë me TVSh ose me 17 ditë vonesë, për të cilën nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “A.....I” dhe komisioni i marrjen në dorëzim të punimeve, ngritur me urdhra nr. 343/1, datë 17.10.2016 i përbërë nga F. TH me detyra Zv/Kryetar, B. R me detyrë jurist dhe XH. TH me detyrë teknik i rrugëve, nuk është bërë i mundur llogaritja e kamatëvonesave në vlerën **391,047 lekë** (Trajtuar hollësisht në pikën III/4 dhe faqen 94-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **391,047 lekë** nga shoqëria “S.....K”.

Brenda datës 30.11.2018

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kontratave të qirasë, konstatohet se për vitin 2016 janë lidhur 37 kontrata për individët që ushtrojnë aktivitet në treg, nga këto 15 individ kanë paguar vlerën e plotë të kontratës së qirasë, kurse 21 individ kanë paguar pjesërisht duke mos arkëtuar vlerën **358,080 lekë**. Për vitin 2017 janë lidhur 29 kontrata, ndërsa për pjesën tjetër nuk janë lidhur kontrata pasi janë debitor në këtë bashki. Kanë paguar detyrimet kontraktuale 41 individ në vlerën 593,555 lekë dhe nuk është arkëtuar vlera **179,924 lekë**, detyrime të kontabilizuar në zyrën e financës. Gjithsej detyrimi i mbetur pa arkëtuar për periudhën 2016 – 2017 paraqitet në vlerën **538,004 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has (Trajtuar hollësisht në pikën III/7 dhe faqen 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **538,004 lekë** dhe në rast mos pagesë të detyrimeve kontraktore të bllokohet aktiviteti dhe prishet kontrata për mos zbatim kushtesh të saj (shlyerje detyrimesh).

Brenda datës 30.11.2018

4. Gjetje nga auditimi: Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtime pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet që legalizohen.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2017, sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 166 persona me vlerë **5,961,090 lekë**, e ardhur e munguar në buxheti e Bashkisë Has, sipas listave që disponon sektori i AUIZNI-t Bashkia Has (Trajtuar hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit dhe Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Has në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të ALUZNI-t dhe ZVRPP Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës

5,961,090 lekë ndaj 166 personave të pajisur me leje legalizimi sipas listave që disponon Sektori i Taksave Vendore Bashkia Has (*pasqyra aneks V/8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda datës 30.11.2018

5. Gjetje nga auditimi: Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Has, kryejnë aktivitetet për shfrytëzim karriere 15 subjekte me kontratë, të cilët kanë në përdorim 21.357 ha sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme. Për këto sipërfaqe nga Agjencia e Pyjeve, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”; pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. Gjithashtu për këto subjekt për periudhën objekt auditimi (2016 – 2017), nuk është bërë i mundur zbatimi i kushteve të kontratës për arkëtimin e vlerën **2,507,622 lekë**, si e ardhur e munguar me dëm në buxhetin e Bashkisë Has (*Trajtuar hollësisht në pikën III/7 dhe faqen 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **2,507,622 lekë ndaj 15 subjekteve** të cilën shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore/ kullosore dhe në rast mos pagese t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në likuidimin e detyrimeve dhe prridhjen e kontratës për mos zbatim të kushteve të saj (pagesën e detyrimeve).

Brenda datës 30.11.2018

6. Gjetje nga auditimi: Ne auditimin e kryer, mbi legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave vendore për licencë karburanti (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” dhe me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; shkronja “b”, dhe pika 9, u konstatua se:

Sipas të dhënave të Sektorit të Taksave Vendore, janë gjithsej 4 subjekte të pajisur me licenca/autorizime, duke mos arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave në vlerën **3,800,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has, në shkelje të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; shkronja (b) dhe pika 9 (*Trajtuar hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Bashkia Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **3,800,000 lekë ndaj 4 subjekteve**, respektivisht:

-**vlera 800,000 lekë**, ndaj subjekti “V.....A”.

-**vlera 1,000,000 lekë**, ndaj subjekti “H.....I”.

-**vlera 1,000,000 lekë**, ndaj subjekti “K.....A”.

-**vlera 1,000,000 lekë**, ndaj subjekti “G.....I”.

Brenda datës 30.11.2018

7. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e procedurave të dhënies me qira të aseteve të bashkisë apo njësive administrative, për vitet 2016 dhe 2017 nga Bashkia Has janë lidhur dy kontrata ;

a) Me Zyrës për Asgjësinë e Sigurimeve Shoqërore me sip 88.96 m² dhe vlerë qiraje 30,000 lekë në muaj e cila është arkëtuar nga qiramarrësi për të dyja vitet, kjo e vërtetuar dhe me mandat arkëtimi bashkëngjitur kontratës.

b) Kontrata nr. 257 rep dhe nr. 217 kol, datë 12.06.2013 lidhur ndërmjet ish- Bashkisë Krumë dhe qiramarrësi G. I për sipërfaqen e tokës bujqësore 4 ha me afat kohor 10 vjet dhe vlerë qiraje 28,000 lekë/ vit. Sipas dokumentacionit të bashkisë, rezulton se subjekt nuk ka arkëtuar detyrimin për vitin 2017 në vlerën **prej 28,000 lekë** e cila ka sjell të ardhura të munguar në buxhetin e Bashkisë Has. *(Trajtuar hollësisht në pikën III/7 dhe faqen 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **28,000 lekë** ndaj subjektit G. I, dhe në rast mos pagesë të kërkohet prishja e kontratës për mos respektim të kushteve (pagesa e detyrimit).

Brenda datës 30.11.2018

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruksion rruga e Pashtrikut, trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksioni Ujësjellës Cahan”*, Bashkia Has, me vlerë të kontratës 35,742,318 lekë me TVSH, fituar nga OE “L.....A”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **672,835 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1893 prot datë 26.09.2016 të lidhur mes AK Bashkia Has dhe OE “L.....A” *(Trajtuar hollësisht në pikën III/4.1 dhe faqen 124-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **672,835 lekë pa TVSh** nga OE “L.....A”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1893 prot datë 26.09.2016 me objekt *“Rikonstruksion rruga e Pashtrikut, trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksioni Ujësjellës Cahan”*, Bashkia Has, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.11.2018

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitimi i skemës ujitëse Helshan 4”*, Bashkia Has, me vlerë të kontratës 42,119,754 lekë me TVSH, fituar nga OE “SH.....T”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,785,090 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 930 prot datë 19.04.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Has dhe Operatorit Ekonomik “SH.....T” *(Trajtuar hollësisht në pikën III/4.1 dhe faqen 124-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **2,785,090 lekë pa TVSh** nga OE “SH.....T”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 930 prot datë 19.04.2017 me objekt *“Rehabilitimi i skemës ujitëse Helshan 4”*, Bashkia Has, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.11.2018

B/II. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TE FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në **Bashkinë Has**, u konstatua se **5 procedura** prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave” dhe me nenet 46, 53 dhe 55, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), veprime të cilat kanë ndikuar në mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të shpenzimeve në fushën e prokurimit, për vlerën e fondit limit prej **234,453,335 lekë**, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, dhe favorizuar operatorët ekonomikë në shumën **27,569,942 lekë**, si më poshtë:

-Në tenderin me objekt: “Projekt zbatimi për eficientë e energjisë në ndërtesën ekzistues 4 kate, në bashkëpronësi, në qendër të qyteti Krumë”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 14,816,032 lekë pa TVSH dhe fitues shoqëria “V.....A” me vlerë kontrate 14,507,603 lekë pa TVSH, konstatohet se ky operator nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK. Vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e shoqërisë “V.....A” nuk është i drejtë dhe duhet të ishte skualifikuar për mos plotësim kriteresh, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.

Skualifikimi i operatorit “A.....C” me vlerë oferte 8,445,138 lekë pa TVSh nga KVO është i padrejtë, pasi nga verifikimi i dokumentacionit në sistem, ky operator plotëson kriteret dhe për më tepër për një kriter për të cilën është skualifikuar nuk e plotëson edhe operatori fitues shpallur nga KVO.

Në këto kushte KVO duhet të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi anomalish të ulët”, dhe të shpallte fitues “A.....C”, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **6,062,465 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE (14,507,603 – 8,445,138).

-Në tenderin me objekt “Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës së Qytetit Krumë-Has”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 87,916,220 lekë pa TVSH dhe fitues BOE “A.....J + D.....5” me ofertë 85,158,603 lekë pa TVSH, konstatohet se:

Vendimi i marrë nga KVO për shpalljen fitues të BOE “A.....J + D.....5”, nuk është i drejtë, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) duhet të anulonte procedurën ose midis dy operatorëve me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, që në rastin konkret është operatorit “A.....C” me vlerë oferte 83,071,081 lekë pa TVSh, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **3,087,522 lekë**.

-Në tenderin me objekt: “Blerje Çakëlli dhe shpërndarje me makineri, dhe riparime tjera të rrugëve rurale Bashkia Has”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 8,333,000 lekë pa TVSH dhe fitues shoqëria “S.....K” me vlerë kontrate 5,750,100 lekë pa TVSH, konstatohet se:

Oferta e paraqitur nga shoqëria “E.....D” me vlerë 5,629,800 lekë pa TVSh (pjesëmarrëse në procedurë) është identifikuar si oferta e suksesshme. Me shkresën nr. 1603, datë 05.08.2016 “njoftim rilidhje kontrate” ose mbas afro 2 muaj nga data e shpalljes së fituesit (kontrata e parë nuk gjendet në dosje), është kërkuar rilidhje kontrate pasi preventivi i publikuar në dokumentet standarte nuk përputhet me preventivin fitues të subjektit, pasi nga subjekti është përsëritur 2 herë sasia e preventivuar, çka ka bërë që të rritet efektivisht vlera e ofertës nga 2,814,900 lekë në vlerën 5,619,800 lekë (preventivi gabim), mangësi e cila nuk është konstatuar nga KVO në momentin e shpalljes si fitues. Për këtë i është

lënë afat subjekti që brenda dy ditëve të paraqitet për rilidhje kontrate për vlerën 2,814,900 lekë pa TVSh ose 3,377,880 lekë me TVSh.

Me vendim nr. 282/1, datë 12.08.2016 të Kryetarit të Bashkisë është kërkuar anulimi e nënshkrimit të kontratës së lidhur me subjektin “E.....D” dhe shpalljen fitues të operatorit të dytë në garë shoqërisë “S.....K” me ofertë 5,750,100 lekë, duke lidhur kontratën nr. 1694, datë 22.08.2016.

Referuar sa më sipër, procedura e ndjekur nga ana KVO dhe Kryetari Bashkisë për anulimin e kontratës së lidhur me subjektin “E.....D” (e cila nuk u gjend) dhe shpalljen fitues të shoqërisë “S.....K” është në kundërshtim me nenin 58, të ligjit nr. 9643, datë 29.12.2014 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 21, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 3, pasi referuar dokumentacionit oferta e paraqitur nga shoqëria “E.....D” dhe për të cilën është kërkuar rinovim kontrate është në vlerën 2,814,900 lekë, është më e madhe se 2% e ofertës së kualifikuar në vend të dytë, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve me efekt negativ në vlerën **2,935,200 lekë**.

- **Në tenderin me objekt:** “Ndërtim rrugë e re segmenti Tobël – Metaliaj, L = 950 ML”, zhvilluar në vitin 2017 me fond limit 2,000,000 lekë pa TVSH dhe fitues shoqëria “O.....N” me vlerë kontrate 1,977,500 lekë pa TVSH, konstatohet se operatori i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST. Vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e shoqërisë “O.....N” me vlerë 1,977,500 lekë pa TVSH, nuk është i drejtë dhe duhet të ishte skualifikuar për mos plotësim kriteresh, siç është vepruar dhe me OE të tjerë. Në këto kushte KVO duhej të anulonte procedurën duke zhvilluar një procedurë tjetër, ose midis operatorëve me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë çmimin me të leverdishëm, për të eliminuar përdorim e fondit me efekt negativ në vlerën **279,500 lekë** pa TVSH.

- **Në tenderin me objekt:** “Rehabilitimi i Rrugës se Fshatit Zahrisht, Has”, zhvilluar në vitin 2017 me fond limit 126,785,883 lekë pa TVSH dhe fitues shoqërinë “P.....U” me vlerë kontrate 126,038,355 lekë pa TVSH, konstatohet se:

Shoqëria “P.....U”, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, dhe procedura duhej anuluar dhe vijonte me një procedurë të re, ose midis operatorëve me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm” (operatorit “B.....B” me vlerë 110,833,100 lekë pa TVSh), veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **15,205,255 lekë**. (Trajtuar hollësisht në pikën III/4 dhe faqen 81-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Has nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, në 3 procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negativ me vlerë **27,569,942 lekë**.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, u konstatua se **11 procedura** janë në shkelje të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, pasi pagesat janë kryer pa dokumente shoqëruese justifikuese të blerjes dhe shpalljes fitues të operatorit si dhe dokumente shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, veprime të cilat kanë në përdorimin pa efektivitet, eficencë dhe economicitet në vlerën **3,830,346 lekë**, konkretisht për rastet:

-Me urdhër shpenzim nr. 338, datë 19.05.2016, është kryer pagesë në shumën **542,000 lekë** me përfitues OE “K. B” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “shërbime riparimi për fadromë J.....3 & J.....7”.

- Me urdhër shpenzim nr. 365, datë 23.05.2016, është kryer pagesë në shumën **119,700 lekë** me përfitues OE “A.....U” ShPK për likuidim shpenzimi me objekt; “blerje materiale hidraulike në funksion të ujitjes dhe kullimit”.
- Me urdhër shpenzim nr. 368, datë 26.05.2016, është kryer pagesë në shumën **780,000 lekë** me përfitues OE “S..... SH” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “punime dhe riparime në ushqyesit të rezervuarëve Qafë-Tobel, Sefoll”.
- Me urdhër shpenzim nr. 386, datë 02.06.2016, është kryer pagesë në shumën **264,000 lekë** me përfitues OE “V.....A” ShPK për likuidim shpenzimi me objekt; “blerje plehra kimik, fidanë, farëra dhe produkte agrokulturore dhe shërbimi.
- Me urdhër shpenzim nr. 400, datë 13.06.2016, është kryer pagesë në shumën **504,000 lekë** me përfitues OE “A.....I” ShPK për likuidim shpenzimi me objekt; “Studi&projektim të KUZ zona Kodra e Madhe”.
- Me urdhër shpenzim nr. 458, datë 08.07.2016, është kryer pagesë në shumën **85,000 lekë** me përfitues OE “H..... C” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “ngarkim, shkarkim, transport mbetje të ngurta në qyteti Krumës dhe shërbime të tjera”.
- Me urdhër shpenzim nr. 520, datë 03.08.2016, është kryer pagesë në shumën **297,833 lekë** me përfitues OE “H..... C” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “ndërrhyrje dhe riparime në rrjeti KUZ lagje Krumë e objekte Njësia Golaj”.
- Me urdhër shpenzimet nr. 523, datë 03.08.2016, dhe nr. 497, datë 19.09.2017 janë kryer 2 pagesa në shumën 107,213 lekë (62820+44393) lekë me përfitues OE “Q. B” (P. Fizik) për likuidim të shpenzimit me objekt; “shërbim larje automjete, tapiceri dhe marrje boti me qira, etj.”.
- Me urdhër shpenzim nr. 466, datë 07.09.2017, është kryer pagesë në shumën **240,000 lekë** me përfitues OE “D..... D” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “ngarkim, shkarkim, transport mbetje të ngurta, shtresa betoni, solete, riparim e shembje rruge”.
- Me urdhër shpenzim nr. 500, datë 26.09.2017, është kryer pagesë në shumën **170,400 lekë** me përfitues OE “B..... K” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “Blerje uniforma për punonjësit”.
- Me urdhër shpenzim nr. 501, datë 02.10.2017, është kryer pagesë në shumën **720,200 lekë** me përfitues OE “K..... B” (P. Fizik) për likuidim shpenzimi me objekt; “shërbime dhe blerje pjesë këmbimi për automjete” (Trajtuar hollësisht në pikën III/3.c dhe faqen 55-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Has të analizojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të **11 procedurave** të blerjeve me vlerë të vogël për vlerën **3,830,346 lekë**, dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Menjëherë

B/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhër me nr. 357, datë 02.11.2016 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” mbi përcaktimin e kapacitetit ujëmbajtës dhe sipërfaqja që zë rruga e Fabrikës Pasurim Kromi Perollaj.

Grupi i punës i përbërë ka konstatuar se subjekti nuk ka lidhur kontratë qiraje për rezervuarin me sipërfaqe 1 ha nga viti 2011 deri në vitin 2017 në bazë të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” lidhja nr. 2 pika 13 numri, ku detyrimi i papaguar paraqitet në vlerën **1,890,000 lekë** (7 vite x 270,000), të cilat kanë sjellë të ardhura të

munguara në Bashkinë Has. *(Trajtuar hollësisht në pikën III/7 dhe faqen 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Has nëpërmjet strukturave të saj, të marrë masat për lidhjen e kontratës me subjektin “F..... P.....” për sipërfaqen ujore (rezervuari) të shfrytëzueshme prej 1 ha, dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimit të munguar për periudhën e aktivitet nga viti 2011 deri në vitin 2017 për vlerën **1,890,000 lekë**.

Brenda datës 30.11.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave për vjeljen e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore, konstatohet se deri më 31.12.2017 gjendja e detyrimeve për taksat e tarifave vendore paraqitet për **60** subjekte me vlerë **12,513,739 lekë**. Konstatohet se nga strukturat e Zyrës së taksave nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e tyre, në të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar *(Trajtuar hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Has, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **12,513,739 lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimor për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Brenda datës 30.11.2018

3. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave Vendore, aplikon tarifa për familjarët vetëm për ato familje të cilët kërkojnë shërbim në Bashkinë Has, ndërsa për të tjerët nuk aplikojnë asnjë vlerë. Kështu referuar të dhënave të gjendjes civile për numrin e familjeve që duhet të paguajnë detyrimet është 6529 familje. Për periudhën objekt auditimi 2016 – 2017, kanë paguar detyrimet 2787 familje për vlerën 2,585,000 lekë, nga e cila për vitin 2016 në vlerën 1,511,000 lekë dhe në vitin 2017 në vlerën 1,074,000 lekë. Nuk është bërë i mundur planifikimi dhe arkëtimi i detyrimeve për 9800 familje në vlerën **9,800,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has *(Trajtuar hollësisht në pikën III/5 dhe faqen 132-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masat për arkëtimin e taksave të familjarëve, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare ose agjentëve të tjerë (ndërmarrja e ujësjellësit), për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara për **vlerën 9,800,000 lekë**.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 8 dhe 9, datë 20.07.2018 (Bashkia Has), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **9 (nëntë) punonjësve**, si më poshtë:

Për 3 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. F. TH, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Has, në cilësinë e Kryetarit të KVO.

2. H. M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kulturës dhe Sportit, dhe

3. N. B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim Zhvillim Territorit.

Në cilësinë e anëtarit të KVO në **5 procedura**, si vijon:

-“Projekt zbatimi për eficientë e energjisë në ndërtesën ekzistues 4 kate, në bashkëpronësi, në qendër të qytetit Krumë”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 14,816,032 lekë pa TVSH,

-“Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës së Qytetit Krumë-Has”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 87,916,220 lekë pa TVSH

- “Blerje Çakëlli dhe shpërndarje me makineri, dhe riparime tjera të rrugëve rurale Bashkia Has”, zhvilluar në vitin 2016 me fond limit 8,333,000 lekë pa TVSH

- “Rehabilitimi i Rrugës së Fshatit Zahrish, Has”, zhvilluar në vitin 2017 me fond limit 126,785,883 lekë pa TVSH.

-“Ndërtim Rruga Pus i Thatë (Lagje Kastrati) Njësia Administrative Gjinaj-Bashkia Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në procedurat e mësipërme, duke pasur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave në DST, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve me impakt negativ në buxhet për vlerën totale të fondit limit 244,517,802 lekë, me efekt financiar në vlerën 27,290,442 lekë, të llogaritur si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike të operatorëve me mangësi, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriterë të paplota e konkretisht, në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (c, ç, d, dh), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes”, neni 24- “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin nr. 8 dhe 9, datë 20.07.2018 dhe pikën III/4, faqet 81-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për 6 anëtarët e Komisionit të Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT).

1. B. R me detyrë jurist në Sektorin Juridik, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT, në **4 procedura**, si vijon:

-“Projekt Zbatimi për Efiçencën e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-Kt, ne Bashkëpronësi, ne qendër te qytetit Krumë”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 14,816,032 lek pa TVSH.

-“Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 87,916,220 lek pa TVSH.

-“Rehabilitimi i Rrugës se Fshatit Zahrisht, Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 126,785,883 lek pa TVSH.

- “Rehabilitim i skemës ujitëse Helshan 4”, zhvilluar në vitin 2017, me fond limit 35,100,000 lek pa TVSH.

2. E. S, me detyrë arkëtare. në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në **3 procedura**;

-“Projekt Zbatimi për Efiçencën e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-Kt, ne Bashkëpronësi, ne qendër te qytetit Krumë”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 14,816,032 lek pa TVSH.

-“Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 87,916,220 lek pa TVSH.

-“Rehabilitimi i Rrugës se Fshatit Zahrisht, Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 126,785,883 lek pa TVSH.

3. D. G, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në **2 procedura**;

-“Projekt Zbatimi për Efiçencën e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-Kt, ne Bashkëpronësi, ne qendër te qytetit Krumë”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 14,816,032 lek pa TVSH.

-“Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 87,916,220 lek pa TVSH.

4. Y. LL me detyrë Inspektor Arsimit në Sektorin e Kulturës dhe Sportit, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në procedurën “Rehabilitimi i Rrugës se Fshatit Zahrisht, Has”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 126,785,883 lek pa TVSH.

5. F. M me detyrë Përgjegjës i Bordit të Kullimit, dhe

6. R. Ç me detyrë Inspektor i Pronave në Sektorin e Planifikim Zhvillim Territorit.

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT në procedurën “Rehabilitim i skemës ujitëse Helshan 4”, zhvilluar në vitin 2017, me fond limit 35,100,000 lek pa TVSH.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në procedurat e mësipërme nga komisioni i hartimit të dokumenteve të tenderit (HDT), janë vendosur kritere të paargumentuara mbi domosdoshmërinë e tyre dhe jo në përshtatje me objektin e prokurimit dhe zërat e preventivave, duke vendosur kritere të rënduara dhe të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në këto procedura dhe përdorimin pa efektivitet dhe eficientë të fondeve të prokuruar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe nenin 41- “Dokumentet e tenderit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, pika 2, ku thuhet: “..... Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre (*Trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin nr. 8 dhe 9, datë 20.07.2018 dhe pikën III/4, faqet 81-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Has ne mungesë të Kryeinspektorit të IMTV, t’i kërkojë **Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës dhe 1 (një) kolaudator** punimesh, si më poshtë:

1. I. D, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikonstruksion rruga e Pashtrikut, trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksioni Ujësjiellës Cahan”, Bashkia Has, me sipërmarrës punimesh OE “L.....A” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **672,835 lekë pa TVSh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. N. XH, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rehabilitimi i skemës ujitëse Helshan 4”, Bashkia Has, me sipërmarrës punimesh OE “SH.....T” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **2,785,090 lekë pa TVSh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikonstruksion rruga e Pashtrikut, trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksioni Ujësjiellës Cahan”, Bashkia Has, me sipërmarrës punimesh OE “L.....A”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **672,835 lekë pa TVSh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. D. XH, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rehabilitimi i skemës ujitëse Helshan 4”, Bashkia Has, me sipërmarrës punimesh OE “SH.....T”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **2,785,090 lekë pa TVSh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt (Trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin nr. 5 dhe 6, datë 19.07.2018 dhe pikën III/4, faqet 120-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gerrat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Has** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të

Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënien për **3 punonjës**, si më poshtë:

a- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c).

1. B. R me detyrë Jurist në Sektorin Juridik, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KBVV).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk ka mbajtur regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, sepse nuk e vendosi në dispozicion të grupit të auditimit, njëkohësisht në zyrën e protokollit nuk rezulton se është dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 janar dhe shtesat për gjatë vitit regjistrat shtesë, në mospërputhje me nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike” të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Ka lejuar të kryhen shpenzime procedurës së prokurimit “blerje e vogël”, nëpërmjet copëzimit të fondit publik, në mospërputhje me pika 8, neni 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, i ndryshuar.

-Në auditimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, konstatohet se 11 procedura janë në shkelje të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, pasi pagesat janë kryer pa dokumente shoqëruese justifikuese të blerjes dhe shpalljes fitues të operatorit si dhe dokumente shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, veprime të cilat kanë në përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet në vlerën **3,830,346 lekë**.

2. E. S me detyrë specialiste në sektorin e financës (arkëtare), në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në auditimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, u konstatua se në 11 procedura janë në shkelje të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, pasi pagesat janë kryer pa dokumente shoqëruese justifikuese të blerjes dhe shpalljes fitues të operatorit si dhe dokumente shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, veprime të cilat kanë në përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet në vlerën **3,830,346 lekë**.

3. I. M, me detyrë ish/përgjegjës specialist i sektorit të ardhurave, për periudhën 2016 (status).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos aplikim të saktë të tarifës vendore për pajisen e subjekteve, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe mos arkëtim të vlerave për dhënien dhe përsëritjen e licencave, në shkelje të VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, të trajtuara në aneksin nr.5/3, me pasojë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Has, në vlerën 3,800,000 lekë

-Mos zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve në vlerën 12,513,739 lekë, në kundërshtim me Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

-Mos aplikim të detyrimeve për taksat e tarifave vendore ndajë abonentëve familjarë, ku për periudhën objekt auditimi (2016 – 2017) nuk është bërë i mundur planifikimi dhe arkëtimi i detyrimeve për 9800 familje në vlerën 9,800,000 lekë.

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (e, ç) e nenit 1, Kreu IV, nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” dhe shkronjës (b) e nenit 9- “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënien masë disiplinore për **9 punonjësit** e mëposhtëm:

a- “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”, shkronjës (b) e nenit 9, të kontratës individuale:

1. Y. LL me detyrë Specialit në Sektorin e Kulturës + Sporteve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KBVV).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në auditimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, konstatohet se 11 procedura janë në shkelje të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, pasi pagesat janë kryer pa dokumente shoqëruese justifikuese të blerjes dhe shpalljes fitues të operatorit si dhe dokumente shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, veprime të cilat kanë në përdorimin pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet në vlerën **3,830,346 lekë**.

2. U. H me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave e Tarifave Vendore, për periudhën 2016 dhe përgjegjës i sektorit të Ardhurave për vitin 2017.

3. N. K me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave e Tarifave Vendore, periudha 2016-2017.

4. A. P, me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave e Tarifave Vendore, për periudhën 2017.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos aplikim të saktë të tarifës vendore për pajisjen e subjekteve, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe mos arkëtim të vlerave për dhënien dhe përsëritjen e licencave, në shkelje të VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, të trajtuara në aneksin nr.5/3, me pasojë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Has, në vlerën 3,800,000 lekë

-Mos zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve në vlerën 12,513,739 lekë, në kundërshtim me Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

-Mos aplikim të detyrimeve për taksat e tarifave vendore ndajë abonentëve familjarë, ku për periudhën objekt auditimi (2016 – 2017) nuk është bërë i mundur planifikimi dhe arkëtimi i detyrimeve për 9800 familje në vlerën 9,800,000 lekë.

5. S. L me detyrë Drejtor i Pyjeve e Kullotave.

6. K. L me detyrë përgjegjës sektori i pyjeve dhe kullotave.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos marrjen e masave për evidentimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/ kollusore, kjo për 15 subjekte me kontratë, të cilët kanë në përdorim 21.357 ha.

Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”; pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Gjithashtu për këto subjekt për periudhën objekt auditimi (2016 – 2017), nuk është bërë i mundur zbatimi i kushteve të kontratës për arkëtimin e vlerën **2,507,622 lekë**.

7. N. B, me detyrë përgjegjës sektori planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos marrjen e masave në zbatim të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet e pajisura me leje legalizimi nga Drejtoria Rajonale ALUZIONI-t Kukës, në arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 166 persona me vlerë **5,961,090 lekë**.

8. O. M me detyrë inspektor IKMT

9. A. B me detyrë inspektor IKMT

Në auditimin e veprimtarisë së IMTV Bashkia Has, konstatohet se nuk është bërë asnjë punë për evidentimin e objekteve të ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, ku për periudhën objekt auditimi (2016 – 2017) evidentohet vetëm një objekt në pronësi të J. I. C, por që nuk ka marrë asnjë masë ligjore.

Ndërkohë nga verifikimi i bërë nga vetë punonjësit Bashkia Has, sipas kërkesës së grupit të auditimit të KLSH, është konstatuar se vetëm në zonën e qendrës Bashkia Has janë evidentuar 6 ndërtime pe leje.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Has, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

F. OPINIONI I AUDITIMIT:

Në bazë të punës audituse të përshkruar në Kreun III të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e Bashkisë Has për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, *jo të përhapura (opinionit të kualifikuar)*, të cilat konsistojnë:

- Në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, në kushtet e paligjshmërisë së shpalljes fitues të operatorëve me vlerë kontrate 234 milion lekë, e cila përbën 65 % e vlerës së kontratave të lidhura të procedurave të audituar, me efekt negativ në vlerën 27.5 milionë lekë.
- Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, ku në 2 raste janë konstatuar shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 4.2 milionë lekë.
- Në fushën e të ardhurave nga mos menaxhimi i kontratave të qirasë në vlerën 4.9 milionë lekë dhe administrimin e taksës së infrastrukturës nga ndërtimet pa lejen dhe në proces legalizimi (ALUIZNI-t), për vlerën 5.9 milionë lekë.

Shënim: Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të rekomandimit për "Masa për shpërblim dëmi", nga ana e Bashkisë Has, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R